



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQUERORE
KËSHILLI ADMINISTRATIV

V E N D I M

Nr. 27, datë 06.12.2019

PËR MIRATIMIN E
R R E G U L L O R E S

**“MBI KRITERET, DOKUMENTACIONIN DHE PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË
KËRKESAVE TË INVALIDËVE PËR RIMBURSIM TË SHPENZIMEVE PËR
BLERJEN E KARBURANTEVE DHE VAJRAVE LUBRIFIKANTË”**

Mbështetur në ligjin nr. 7703 datë 11.5.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të ISSH, Këshilli Administrativ në mbledhjen e tij të datës 06.12.2019

V E N D O S I

1. Miratimin e Rregullores “ Mbi kriteret, dokumentacionin dhe procedurat e vlerësimit të kërkesave të invalidëve për rimbursim të shpenzimeve për blerjen e karburanteve dhe vajrave lubrifikantë”
2. Shfuqizimin e Rregullores nr. 7 datë 24.12.2009 “Për zbatimin e ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “ Për statusin e invalidëve të punës , i ndryshuar“.
3. Anëtar i komisionit, përfaqësues nga shoqata e invalidëve të punës do të shpërblehet në nivelin e pagesës sa një anëtar mjek i KMCAP-i Rajonal, për çdo mbledhje që zhvillohet, por jo më shumë se një herë në muaj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
I KËSHILLIT ADMINISTRATIV

Anila DENAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE
KËSHILLI ADMINISTRATIV**

RR E G U L L O R E

**“MBI KRITERET, DOKUMENTACIONIN DHE PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË
KËRKESAVE TË INVALIDËVE PËR RIMBURSIM TË SHPENZIMEVE PËR
BLERJEN E KARBURANTËVE DHE VAJRAVE LUBRIFIKANTË”**

Në mbështetje të pikës 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.723, datë 19.11.1998 “Për zbatimin e ligjit nr.7889, datë 14.9.1994 “Për statusin e invalidëve të punës”, të ndryshuar dhe në mbështetje të nenit 74 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH), vendosi:

**KREU I
TË PËRGJITHSHME**

I. Objekti

Rregullorja “Mbi kriteret, dokumentacionin dhe procedurat e vlerësimit të kërkesave të invalidëve për reimbursim të shpenzimeve për blerjen e karburantëve dhe vajrave lubrifikantë”, ka si objekt përcaktimin e kritereve, dokumentacionit dhe procedurat lidhur me vlerësimin e kërkesave të invalidëve për reimbursim të shpenzimeve për blerjen e karburantëve dhe vajrave lubrifikantë.

II. Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullore është:

- a) të krijojë një kuadër nënligjor për reimbursimin të shpenzimeve për blerjen e karburantëve dhe vajrave lubrifikantë të invalidëve;
- b) të përcaktojë kritere, dhe dokumentacionin e nevojshëm dhe të unifikojë procedurën e regjistrimit të kërkesave, përpunimin e tyre dhe vendim marrjen përkatëse;
- c) të përcaktojë të gjithë procedurat, në përputhje të plotë me kuadrin ligjor dhe nënligjor;
- ç) të garantojë vlerësimin e drejtë dhe substancial të dokumentacionit të paraqitur, si baza

për caktimin e këtij përfitimi.

III. Përkufizime

Në funksion të kësaj rregulloreje, termat e përdorur kanë këtë kuptim:

“invalid”: personi që ka humbur aftësinë për punë në masën jo më pak se 67 për qind, për shkak të aksidentit në punë, grapi plotë me përkujdesje për shkak të sëmundjes së përgjithshme, invalid me status paraplegjik, tetraplegjik, në pension të plotë invaliditeti, i vlerësuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për punë;

“Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP)”: grup mjekësh specialistë në çdo DRSSH, të cilët kanë për detyrë të vlerësojnë gjendjen shëndetësore të të sëmurit dhe të caktojnë shkallën e humbjes së aftësisë për punë, sipas kritereve mjekësore dhe ligjore të përcaktuara në legjislacionin në fuqi;

“Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë Epor”: grup mjekësh specialistë, të cilët vlerësojnë vendimmarrjen e KMCAP rajonal lidhur me gjendjen shëndetësore të të sëmurit, sipas kritereve mjekësore dhe ligjore të përcaktuara në legjislacionin në fuqi;

“Mjet levizës, autoveturë”: janë ato të përcaktuara në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë;

“Mjet levizës motorik i thjeshtë”: është triçikël me motor, bicikletë me motor;

“Komisioni i Veçantë në ISSH”: komision i posaçëm i ngritur në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumenteve të bashkëlidhura me kërkesën përimbursim të shpenzimeve për blerjen e karburantëve dhe vajrave lubrifikantë.

“Kompetencë”: tërsia e të drejtave, detyrimeve dhe rrathi i çështjeve që mund të shqyrtojë dhe të zgjidhë Komisioni, në bazë të akteve ligjore e nënligjore;

“Dosje invaliditeti”, tërsia e dokumentacionit të paraqitur nga invalidi dhe e dokumentacionit plotësues të administruar nga punonjësit e autorizuar të DRSSH, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në Rregulloren “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”

“praktikë”, tërsia e dokumentacionit të paraqitur nga kërkuesi bashkëlidhur kërkesës përimbursim të shpenzimeve për blerjen e karburantëve dhe vajrave lubrifikantë dhe e dokumentacionit plotësues të administruar nga punonjësit e autorizuar të ISSH, përfshirë dhe dosjen e invaliditetit.

“Dokumentacioni i mjetit, dokumentacioni i blerjes së mjetit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, kur mjeti është blerë brenda territorit të Shqipërisë dhe sipas legjacionit të shtetit përkatës, kur mjeti është blerë jashtë territorit të Shqipërisë; Çertifikata e Pronësisë së Mjetit Rrugor.

IV. Administrimi

1 Fondi për rimbursim të shpenzimeve për blerjen e karburantëve dhe vajrave lubrifikante për invalid programohen në buxhetin vjetor të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

2 Sektori i Ekspertizës në Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, bazuar në gjendjen shëndetësore, shkakut të invaliditetit, moshës dhe mundësisë për riaftësim fizik apo profesional, evidenton çdo vit invalidët që plotësojnë kriteret mjekësore për rimbursim të shpenzimeve për blerjen e karburantit dhe vajrave lubrifikantë.

KREU II

PËRFITUESIT, KRITERET E PËRFITIMIT DHE DOKUMENTACIONI

I. Kriteret mjekësore

Përfitojnë rimbursim të shpenzimeve për blerjen e karburantëve dhe vajrave lubrifikantë personat e deklaruar invalid me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë që plotësojnë këto kriterë mjekësore:

- invalid për shkak të aksidentit në punë, me lloj invaliditeti të plotë, të përhershëm, me pamundësi të plotë lëvizje, humbje e aftësisë për punë në masën e barabartë dhe mbi 67 për qind;
- invalid me status paraplegjik, tetraplegjik, në pension të plotë invaliditeti, me pamundësi definitive të lëvizjes (ecjes).
- *kur shkaku i invaliditetit është si rrjedhojë e sëmundjes së përgjithshme*, me invaliditet të plotë me përkujdesje, kriteri mjekësor i përfitimit është pamundësi definitive e lëvizjes.

II. Kriteret teknike

1 Rimbursimi i shpenzimeve për blerjen e karburantëve dhe vajrave lubrifikantë bëhet për mjetet levizëse motorike në pronësi të invalidit që plotëson këto kushtë teknike:

- triçikël me motor, bicikletë me motor;
- deri në 1600 kubik, për mjetet me benzinë,
- deri në 1900 kubik, për mjetet me naftë,
- në raste të veçanta me vendim të komisionit për mjete me cilindrate mbi nivelin e caktuar të kubikëve, me kusht që mjeti të jetë i përshtatur për invalid.

2 Invalidi që ka përfituar njëherë të drejtën e rimbursimit të shpenzimeve të blerjes së karburantit dhe vajrave lubrifikantë, ka të drejtë të bëjë sërisht kërkësë për këtë përfitim, vetëm nëse mjeti për të cilin ka përfituar rimbursimin vërtetohet nga institucioni kompetent se ka dalë jashtë përdorimi dhe nëse është shitur, dhuruar apo falur, të vërtetohet se personi që i është shitur, falur apo

dhuruar mjeti, ka shlyer të gjitha detyrimet që lindin për shkak të posedimit të mjetit, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

III. Dokumentacioni

1 Invalidi për të përfituar rimbursimin e shpenzimeve për blerjen e karburantëve dhe vajrave lubrifikantë duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- Fotokopje të dokumentit të identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë);
- Çertifikata e pronësisë së mjetit rrugor, e lëshuar nga autoriteti kompetent, në emër të invalidit
- Dëshmi e Aftësisë së Drejtimit të Mjetit;
- Leje e qarkullimit të mjetit; dokumenta të tjera të mjetit.
- Akti i blerjes apo i dhurimit të mjetit sipas legjislacionit në fuqi të shteteve përkatëse;
- Dokumenti i çregjistrimit dhe nxjerrjes jashtë qarkullimi në vendin e origjinës (kur mjeti është blerë jashtë Republikës së Shqipërisë);
- Vërtetim nga Shërbimi Social Shtetëror (Drejtoria Rajonale), që nuk përfiton rimbursim të shpenzimeve për blerjen e karburantëve dhe vajrave lubrifikantë nga ky institucion.
- Prokurë e posaçme e hartuar sipas kërkesave të Kodit Civil, për rastet kur invalidi për shkak të llojit dhe shkallës së paftësisë për punë e ka të pamundur të drejtojë mjetin rrugor. E drejta për drejtimin e mjetit rrugor duhet t'i jepet një pjesëtari të familjes në ngarkim dhe kur nuk ka, i jepet një të afërmë. Mjeti i përdorur nga personi i autorizuar duhet të jetë në zotërim të invalidit dhe përdoret vetëm për nevojat e invalidit. Në këtë rast duhet paraqitur edhe autorizimi për administrimin e dokumenteve përkatëse elektronike nga punonjësit përgjegjës të DRSSH dhe Dëshmia e Aftësisë së Drejtimit të Mjetit.

2 Dokumentacioni i mësipërm duhet të jetë brenda afatit të vlefshmërisë sipas legjislacionit në fuqi, origjinal, ose kopje e njësuar me origjinalin me akt notarial. Kur dokumentacioni i mjetit është në gjuhë të huaj, duhet të jetë i përkthyer dhe i vërtetuar nga noteri sipas rregullave në fuqi.

3. Drejtoria e Doganave, informon Institutin e Sigurimeve Shoqërore, me kërkesën e këtij të fundit, lidhur me procedurat e kalimit të pronësisë së mjetit kur ato janë kryer jashtë Republikës së Shqipërisë.

KREU IV

PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE SHQYRTIMI I DOKUMENTACIONIT

I. Procedurat e aplikimit

1 Përfitimi i rimbursimit të shpenzimeve për blerjen e karburantëve dhe vajrave lubrifikantë jepet vetëm me kërkesën e invalidit ose personit të autorizuar me prokurë të hartuar sipas kërkesave të Kodit Civil.

2 Kërkesat, së bashku me dokumentet e përcaktuara në pikën 3, të Kreut II, të Rregullores, paraqiten dhe administrohen në sportelet e shërbimit, në ato bashki, në territorin e të cilës funksionon DRSSH-ja, që administron dosjen e pensionit të invaliditetit, sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin që rregullon mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel.

3 Kërkesa për rimbursim të shpenzimeve për blerjen e karburantëve dhe vajrave lubrifikantë (*modeli bashkëlidhur*), regjistrohet, administrohet dhe dërgohet në DRSSH, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në Rregulloren “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”.

II. Procedura e shqyrtimit në DRSSH

1 Kërkesa për rimbursim të shpenzimeve për blerjen e karburantëve dhe vajrave lubrifikantë pas protokollimit në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, i adresohet Specialistit të Ekspertizës Mjekësore brenda ditës së punës.

2 Specialisti i Ekspertizës Mjekësore regjistrон kërkesën në një regjistër të veçantë për këtë qëllim dhe brenda ditës së nesërme të punës kërkon térheqjen e dosjes nga Arkivi, sipas rregullave.

3 Specialisti i Ekspertizës Mjekësore, vlerëson dokumentacionin e paraqitur dhe atë të administruar në dosje në raport me kërkesat e Rregullores dhe përgatisin relacionin me konstatimet përkatëse për Komisionin Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë.

4 Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë në mbledhjen më të afërt nga data e kërkesës së invalidit, në mbështetje të praktikës, të gjendjes shëndetësore dhe kriteret e përfitimit, merr vendim të posaçëm (*modeli bashkëlidhur*), duke i rekomanduar Komisionit të Veçantë të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, pranimin e kërkesës së invalidit. Në rast të refuzimit të kërkesës nga KMCAP-i Rajonal përfituesi ka të drejtën e apelimit të vendimit në KMCAP-in Epror brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit. KMCAP-i Epror shqyrton dhe zgjidh rastet e dërguara me divergjencë nga KMCAP-et Rajonale.

5 Praktika së bashku me vendimin e posaçëm dërgohen në Institutin e Sigurimeve Shoqërore brenda ditës së nesërme të punës nga vendimmarrja e Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë me shkresë të nënshkruar nga titullari i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (*modeli bashkëlidhur*).

III. Procedura e shqyrtimit në ISSH

1 Praktika e ardhur nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, regjistrohet brenda ditës së punës në një regjistër të veçantë, i cili administrohet nga sekretarja e Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë Epror.

2 Praktika dërgohet për shqyrtim brenda ditës së nesërme të punës në Komisionin e Veçantë, të ngritur me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm.

3 Komisioni përbëhet nga 5 (pesë) anëtar, me përfaqësues nga Drejtoria Juridike (jurist), Drejtoria e Finances (financier), Drejtoria e Perfitimeve (mjek i ekspertizës mjekësore), Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm (inxhinier), si dhe një përfaqësues nga Shoqata e Invalidëve të Punës.

4 Komisioni në raste të veçanta, ka të drejtë të kërkojë komisionimin e invalidit në Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë Epror, në këtë rast harton një relacion të detajuar për konstatimet dhe i paraqitet për miratim Drejtorit të Përgjithshëm, për vijimin e procedurës së komisionimit.

5 Komisioni, kur konstaton mangësi në dokumentacionin e paraqitur nga invalidi, apo mosrespektim të procedurës, të kuadrit ligor/nënligor nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, harton shkresën me konstatimet përkatëse dhe e kthen praktikën për plotësim, zyrtarisht me shkresë përcjellëse të nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm.

6 Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e plotë për vlerësim të kritereve mjekësore, teknike dhe ligjore merr vendim, të cilin ja paraqet për miratim Drejtorit të Përgjithshëm të ISSH.

7 Vendimi i Komisionit (*modeli bashkëlidhur*) hartohej në tre kopje, një kopje së bashku me praktikën i dërgohen Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, një kopje administrohet në Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe një kopje së bashku me fotokopjen e praktikës administrohet nga komisioni.

8 Praktika e invalidit dërgohet zyrtarisht në Drejtorinë Rajonale me vendimet përkatëse me shkresë përcjellëse.

IV. Procedura të tjera

1 Brenda ditës së punës nga protokollimi në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore i praktikës së dërguar nga Institut i Sigurimeve Shoqërore, Specialisti i Ekspertizës Mjekësore bën shënimet përkatëse në regjistrin e posaçëm dhe njofton zyrtarisht invalidin (*modelet bashkëlidhur*), për vendimmarjen lidhur me kërkesën e tij.

2 Dega e Financës në zbatim të vendimit të dërguar nga ISSH, çdo muaj bën likujdimin e vlerës përkatëse për rimbursim të shpenzimeve për blerjen e karburantëve dhe vajrave lubrififikantë.

3 Invalidi përfitues paraqitet në DRSSH për nënshkrimin e kontratës me Drejtorin e DRSSH-së

(*modeli bashkëlidhur*). Kontrata përpilohet në tre kopje dhe pasi nënshkruhet nga të dyja palët, një kopje i jepet personit përfitues, një kopje administrohet në dosje dhe një kopje mbahet nga

mjeku i eksperizës

4 Dokumentacioni i paraqitur nga invalidi dhe dokumentacioni procedural administrativ, administrohen në dosjen e invaliditetit, e cila pas përfundimit të procedurave të pagesës nga Dega e Financës, dërgohet për administrim në Degën e Arkivit.

**KREU IV
TË FUNDIT**

Pagesat për efekt të rimbursimit të shpenzimeve për blerjen e karburantëve dhe vajrave lubrifikantë, janë objekt i inspektimit dhe auditimit nga strukturat përkatëse në Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

Rregullorja nr.7, datë 24.12.2009 “Për zbatimin e ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidëve të punës”, të ndryshuar”, e ndryshuar, shfuqizohet.

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
I KËSHILLIT ADMINISTRATIV**

Anila DENAJ